

Член 7

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за пензиското и инвалидското осигурување.

Член 8

Одредбите на членот 1 од овој закон ќе започнат да се применуваат по една година од денот на влегувањето во сила на овој закон, освен одредбите кои се однесуваат на условот за познавање на странски јазик кои ќе започнат да се применуваат по две години од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Одредбите на членовите 2, 3 и 4 од овој закон ќе започнат да се применуваат со денот на започнувањето на примената на Законот за вработените во јавниот сектор („Службен весник на Република Македонија“ број 27/14) и Законот за административните службеници („Службен весник на Република Македонија“ број 27/14).

Член 9

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13 dhe 170/13), në nenin 159 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Konkursi nga paragrafi (1) i këtij neni shpallet në tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, prej të cilëve njëri nga gazetata të cilat botohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetareve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase."

Neni 2

Neni 160 ndryshon si vijon:

"Për drejtorin, respektivisht zëvendësdrejtorin e Fondit emërohet person fizik vendas i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- 3) ka kryer arsim të lartë dhe ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallën VII/1;
- 4) ka minimum pesë vite përvojë pune nga sfera e drejtësisë, financave, ekonomisë dhe sigurimit pensional;
- 5) do të ofrojë program më kualitativ për punë në Fond;
- 6) posedon një nga certifikatat e pranuara ndërkombëtare ne vijim ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo me të vjetër se pesë vite:
 - TOEFEL IBT së paku 76 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) - (Cambridge English: Legal) - së paku B2 (B2) niveli,
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
- 7) ka të dhënë test psikologjik dhe test për integritet."

Neni 3

Në nenin 161 pas pikës 1 shtohet pikë e re 2, si vijon:
"2) miraton plan vjetor për punësim në pajtim me nevojat e Fondit dhe parimet për përfaqësim të drejtë dhe adekuat, ndërsa në bazë të Metodologjisë për planifikim të punësimeve në sektorin publik;"

Pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 bëhen pika 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijon:

"(2) Pëlqim për planin vjetor për punësim jep Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(3) Plani vjetor nga paragrafi (1) pika 2 të këtij neni miratohet deri më 30 shtator të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm".

Neni 4

Neni 164 ndryshon si vijon:

"(1) Punët profesionale, juridike normative, administrative, mbikëqyrëse-administrative, materiale-financiare, të kontabilitetit, informatike dhe punët tjera nga Fondi i kryen shërbimi profesional organizimi i brendshëm i të cilit, fushëveprimi i punës dhe kushtet për punësim më afër rregullohen me aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim të punës dhe detyrave.

(2) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni Fondi formon shërbim të veçantë profesionist, filiale dhe rregullore.

(3) Të punësuarit në shërbimin profesional nga paragrafi (2) i këtij neni kanë status të nëpunësve administrativë, në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(4) Të punësuarit në Fond, të cilët kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të personelit ndihmësteknik, në pajtim me Ligjin për të punësuar në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune."

Neni 5

Nenet 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183 dhe 184 shlyhen.

Neni 6

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Fondit i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 1 të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 7

Autorizohet Komisioni Juridik-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 8

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat e neneve 2, 3 dhe 4 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".